




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
DREJTORIA RAJONALE E OFRIMIT FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK
ELBASAN**

Nr 183 Prot

Elbasan më, 12.04.2022

Lënda: Njoftim për vend të lire.

AGJENCISË KOMBËTARË TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE.

Në zbatim të ligjit nr 15/2019, "Për nxitjen e punësimit" ; të ligjit nr 15/2017 " Për arsimin dhe formimin profesional në republikën e Shqipërisë " ; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr 554 datë 31.07.2019 " Për krijimin , mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombetare të punësimit dhe aftësive " ; të udhëzimit nr 14 datë 27.05.2021 " Për mënyrën e organizmit dhe veprimtarinë e ofruesve public të arsimit dhe formimit profesional".

Ofruesi publik i AFP-së Drejtorisë Rajonale të Ofrimit Formimit Profesional Publik Elbasan , ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin :

- Instruktor/e Berber - 1 person

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme :

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vëpruar;
- b) Të jetë në kushtë shëndetësorë që e lejojnë të kryesj detyrën
- c) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale
- d) Të mos ket ndaj tij masa disiplinore që nuk jan shuar;
- e) Te demostrojë vlera të larta të etikës, sjelljes, dhe komunikimit;
- f) Të demostrojë aftësi të punës ne grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) Të ketë diplome nga nje shkolle e mesme profesionale ose kualifikim profesional pas te mesem ne profesionin e kursit te formimit profesional qe aplikon;
- b) Të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushen ne te cilen eshte kualifikuar;
- c) Të njohë dhe të përdore teknologjinë e informacionit

Dokumentet e aplikimit

1. Dosja e aplikantit e cila permban dokumentacionin e kerkuar sipas njoftimit te vendit te lire , duhet te perfshije.

- a) letermotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në)
- c) kartën e indentitetit
- d) diplomë
- e) libreza e punës
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në jeteshkrim;
- g) certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vertetim i gjendjes shendetesore
- i) vërtetimin e gjendjes gjyqësore
- j) vërtetim nga punëdhënësi i fundit , që ndaj tij nuk ka masa disiplinore në fuqi;
- k) te pakten nje rekomandim ose vlerësim pune nga punë dhënës të mëparshëm;

2. Te gjitha dokumentat duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara te tyre.

Dokumentet ne gjuhen e huaj duhet te jene te perkthyer ne gjuhen shqipe dhe te noterizuara.

3. Dokumentet e aplikimit dorëzohen ne protokollin e ofrusit të AFP-së brenda dates.....26.04.2022.

